



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 618/6 prot.

Tiranë, më 08.09.2021

VENDIM

Nr.105, datë 08.09.2021

**PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT MBI VERIFIKIMIN E LIGJSHMËRISË SË
PROCESIT TË EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT TË FORMËS SË PRERË PËR
PUNONJËSEN *****.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Çështjet Juridike dhe Marrëdhëniet me Jashtë, në lidhje me verifikimin e kërkesës për për ekzekutimin e vendimit të formës së prerë për punonjësen *****.

KONSTATOVA SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet kërkesave të regjistruara me nr. 618 prot., datë 14.05.2021 dhe nr.618/2 prot., datë 15.06.2021, ka marrë dijeni në lidhje me disa pretendime të ngritura prej kërkuases ***** në lidhje me mosekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë.

Në informacionin e përcjellë nëpërmjet ankesës së sipërcituar, kjo punonjëse kërkon ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formës së prerë, në të cilin është vendosur përfitimi i një shpërblimi të dëmit për zgjidhjen e kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme..

Nga shqyrtimi i kërkesës me nr. 618 prot., datë 14.05.2021, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj, e veçanërisht Vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë me Nr. 438, Regj. Them. Nr. 00-2014-2306, datë 10.07.2014, rezulton se marrëdhënia e punësimit e kësaj punonjëseje si Specialiste në Zyrën Rajonale të Punësimit Shkodër ka qenë një marrëdhënie kontraktuale, e cila ka filluar në datën 25.02.2002 dhe ka përfunduar në

datën 31.08.2010, me aktin e lirimimit nr.1852, të Drejtorisë së Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Referuar ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999, “*Statusi i nëpunësit civil*”, tashmë i shfuqizuar, i cili ka qenë në fuqi në atë kohë, institucionet e varësisë, përfshi Drejtorinë e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, nuk kanë qenë pjesë e shërbimit civil. Njëkohësisht, hyrja në fuqi e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në datën 26.02.2014, nuk e ka gjetur këtë punonjëse të punësuar në pozicionin në fjalë, për shkak të ligjit.

Në lidhje me këtë fakt, Komisioneri i ka kthyer përgjigje ankueses me shkresën nr. 618/1 prot., datë 01.06.21. Pas kësaj ankuesja i është drejtuar përsëri Komisionerit me shkresën 618/2 prot., datë 15.06.21, nga përmbajtja e së cilës nuk konstatohet asnjë rrethanë e re në lidhje me këtë rast.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në ligjin nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe në nenin 16, pika “10”, të Rregullores “*Për procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit*”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë së procesit të ekzekutimit të vendimit të formës së prerë për punonjësen ***** dhe arkivimin e çështjes.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha